

VENDIM
Nr.504, datë 23.6.2010

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, PËR SHPENZIME KORENTE, NDËRMJET
PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve, për shpenzime korente, ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, si më poshtë vijon:

a) Programit “Planifikim, menaxhim dhe administrim” t’i shtohet fondi 13 500 000 (trembëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë.

b) Programit të Publikimeve Zyrtare t’i pakësohet fondi 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

c) Programit të Sistemit të Burgjeve t’i pakësohet fondi 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë.

ç) Programit të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor t’i pakësohet fondi 2 000 000 (dy milionë) lekë.

d) Programit të Shërbimit për Çështjet e Birësimeve t’i pakësohet fondi 1 000 000 (një milion) lekë.

dh) Programit të Shërbimit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme t’i pakësohet fondi 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

e) Programit të Shërbimit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave t’i pakësohet fondi 2 000 000 (dy milionë) lekë.

ë) Programit të Shërbimit të Provës t’i pakësohet fondi 3 000 000 (tre milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha